Subjekti

SALILLARI sh.p.k

Forma juridike:Shoqëri me Pëgjegjesi të Kufizuar

Data e themelimit: 10 Gusht 1994

Numri unik i indentifikimit(NIPT): J 62903125 G

Selia: Ura Vajgurore ,Berat

Nr.tel.042253 619 e-mai:salillari@abcom.al

Ndërtim Imp Exp SALILLARI Shpk BERAT ALBANIA

Objekti tregtar: Sherbime ndertimi

Pasqyrat Financiare Vjetore 2008

(Mbyllur më 31.12.2008)

NJËSOHET ME ORIGJINAL

DREJTORI

DUMAN CANO

Pasqyra financiare: Individuale(jokonsoliduara)

Periudha kontabel: Nga 01.01.2008 deri më 31.12.2008

Data e mbylljes:25 Mars 2008

Monedha: Leke

Shkalla e rrumbullakimit: ne leke

REPUBLIKA E SHQIPERISE DREJTORIA RAJONALE TATIMORE BERAT 93 27.03.2009

27/03/2009

Berat, Mars 2008

Tabela e përmbajtjes

A. RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR 0

B. BILANCI KONTABEL 2

C. PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE 3

D. PASQYRA E FLUKSIT TE PARASE 4

E. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALET E VETA 5

F. SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE 6-13

Ndërtim Imp Exp SALILLARI Shpk BERAT ALBANIA

Ekspert Kontabël i Autorizuar Afrim Suli
Licenca profesionale
Nr.4, date 11.01.2000

Rr. "Sami Frashëri", pall. "T.D.J",
Kat.3/3,(Univer."Marin Barleti"),Tiranë,
Cel: 069 20 99 204
Tel/fax: (04) 2 244 237
E-mail: afrim.suli@hotmail.com

Raport i Audituesit të Pavarur

Për Ortakët e shoqerise "SALILLARI" sh.p.k
Adresa: Ura Vajgurore,Berat

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkangjitur të shoqërisë "SALILLARI" sh.p.k, të cilat përbëhen ngabilanci kontabël i dates 31 Dhjetor 2008, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyra e rrjedhjes së parasë dhe pasqyra e ndryshimeve në kapitalin e vet për vitin e mbyllur ne atë date, si dhe një përmbledhje e metodave të rëndësishme kontabël dhe shënimeve të tjera spjeguese.

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Shqipëtare të Raportimit Financiar. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, vënien në zbatim dhe mbajtjen e kontrollit të brendëshëm të përshtatshëm mbi përgatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet të pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimit; zgjedhjen dhe zbatimin e metodave të përshtatëshme kontabël; dhe kryerjen e çmuarjeve kontabël të arsyeshme për rrethanat e dhëna.

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi yne u krye në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të zbatojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë e kryejmë auditimin tonë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale.Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen prej gjykimit të audituesit,duke përfshirë vlerësimin e rreziqeve për anomali materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose të gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendëshëm përkatës të entitetit në përgatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet të pasqyrave financiare në mënyrë që të hartojë procedurat e auditimit që janë të përshtatëshme për rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit për efektivitetin e kontrollit të brendëshëm të entitetit.
Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatëshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe për vlerësimin e paraqitjes së përgjithëshme të pasqyrave financiare

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi marre është e mjaftueshme dhe e përshtatëshme për të dhënë bazat për opinionin tonë të auditimit me rezervën e mëposhtme.

Ne nuk e vëzhguam inventarizimin fizik të fundit të vitit, të datës 31 Dhjetor 2008, meqë ajo datë ishte para datës që ne u angazhuam fillimisht si auditues të shoqërisë. Për shkak të mënyres se ndjekjes së inventarit,

ne nuk ishim në gjëndje që, duke u nisur nga proçedura të tjera auditimi, të bindeshim në lidhje me sasitë e stokut.

Sipas opinionit tonë me perjashtim të efekteve në pasqyrat financiare te çeshtjeve që referohen në paragrafin paraardhës, pasqyrat financiare, japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të pozicionit(gjëndjes) financiare të shoqërisë "SALILLARI" sh.p.k., në datën 31 Dhjetor 2008, të rezultatit financiar dhe flukseve të saj të parave për ushtrimin e mbyllur, në pajtim me Standartet Shqipëtare të Rraportimit Financiar.

Afrim SULI

Ekspert Kontabël i Autorizuar

AUDIT I PAVARUR

TIRANA - ALBANIA

Tiranë, më 28 Mars 2009

Bilanci kontabël
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008
(Të gjitha balancat janë në lekë)

		Shenimi nr.	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2008	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2007
A	**AKTIVET**			
I	**Aktive Afatshkurtera**			
	Aktive monetare	3	50,828,149	76,008,324
	Derivativë dhe aktive të mbajtura për tregtim		-	-
	Aktive të tjera financiare afatshkurtra	4	1,524,581,388	1,185,839,609
	Inventari	5	22,895,361	48,364,758
	Aktivet afatshkurtra të mbajtura për shitje		-	-
	Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	4	10,357,476	10,357,476
	Totali i Aktiveve Afatshkurtera(I)		1,608,662,374	1,320,570,167
II	**Aktive Afatgjata**			
	Investimet financiare afatgjata	6	42,714,000	42,714,000
	Aktive afatgjata materiale	6.0	698,139,904	743,178,919
	Aktivet afatgjata jomateriale		-	-
	Kapital aksionar i papaguar		-	-
	Aktive të tjera afatgjata		-	-
	Totali i Aktiveve Afatgjata(II)		740,853,904	785,892,919
	TOTALI I AKTIVEVE (I + II)		**2,349,516,278**	**2,106,463,086**
B	**DETYRIMET DHE KAPITALI**			
I	**Detyrime Afatshkurtera**			
	Huamarrjet	7	27,559,782	131,982,696
	Huatë dhe parapagimet	8	1,315,253,244	1,045,485,116
	Grantet dhe të ardhurat e shtyra		-	-
	Provizionet afatshkurtra		-	-
	Totali i Detyrimeve Afatshkurtera (I)		1,342,813,026	1,177,467,812
II	**Detyrime Afatgjata**			
	Huatë afatgjata	9	-	-
	Huamarrje të tjera afatgjata		-	-
	Provizionet afatgjata		-	-
	Grantet dhe të ardhurat e shtyra			-
	Totali i Detyrimeve Afatgjata (II)		-	-
	Totali i Detyrimeve (I+II)		1,342,813,026	1,177,467,812
III	**Kapitali**			
	Kapitali i rregjistruar (aksionar)	10	816,312,000	816,312,000
	Primi i aksionit		-	-
	Njësitë ose aksionet e thesarit (negative)		-	-
	Rezerva statutore		-	-
	Rezerva ligjore	10	14,282,605	14,282,605
	Rezerva të tjera	10	94,843,131	-
	Fitimet(humbja) te pashpërndara		3,557,538	3,557,538
	Fitimi (humbja) e vitit financiar	11	77,707,978	94,843,131
	Totali i Kapitalit (III)		1,006,703,252	928,995,274
	TOTALI I DETYRIMEVE E KAPITALIT (I,II,III)		**2,349,516,278**	**2,106,463,086**

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërese e këtyre pasqyrave financiare.

Ndërtim Imp Exp SALILLARI Shpk BERAT ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPERISE QENDRA E REGISTRIMIT TE SHOQERIVE TIRANE DREJTORIA RAJONALE TATIMORE

REGISTRI

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008
(Të gjitha balancat janë në lekë)

		Shenimi nr.	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2008	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2007
1	Shitjet neto	11	1,436,505,637	1,332,288,263
2	Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit(Puna	.	46,772,764	1,434,900
3	Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshme dhe	.	-	-
4	Materialet dhe mallrat e konsumuara	11	(753,681,525)	(731,626,673)
5	Kosto e punës	11		
	Pagat e personelit		(134,617,047)	(45,073,681)
	Shpenzimet per sigurimet shoqërore dhe shëndetsore		(23,906,780)	(9,679,810)
6	Amortizimet dhe zhvlerësimet		(99,643,525)	(101,629,816)
7	Shpenzime të tjera		(376,798,078)	(316,638,820)
8	**Totali i shpenzimeve (shuma 4 - 7)**		(1,388,646,955)	(1,204,648,800)
9	**Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore (1+2+/-3-8)**		**94,631,446**	**129,074,363**
10	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njësitë e kontrolluara		-	-
11	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesëmarrjet		-	-
12	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare	11	-	-
	12.1 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investime të tjera financiare afatgjata		-	-
	12.2 Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat 767, 667		(8,232,879)	(11,276,515)
	12.3 Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi 769, 669		852,839	1,911,851
	12.4 Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare 768, 668		-	-
13	**Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare (**		(7,380,040)	(9,364,664)
14	**Fitimi (humbja) para tatimit (9+/-13)**	0	**87,251,406**	**119,709,699**
15	**Shpenzimet e tatimit mbi fitimin 69**	12	**9,543,428**	**24,866,568**
16	**Fitmi (humbja) neto e vitit financiar (14-15)**	11	**77,707,978**	**94,843,131**
17	**Elementët e pasqyrave të konsoliduara**		-	-

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërese e këtyre pasqyrave financiare.

Ndërtim Imp Exp SALILLARI Shpk BERAT ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPERISE DREJTORIA RAJONALE E TATIMEVE

DREJTORI
JOVAN CANO

Pasqyra e rrjedhjes së parasë(cash flow)
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008
(Të gjitha balancat janë në lekë)

	Shenimi nr.	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2008	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2007
Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit			
Fitimi para tatimit		87,251,406	119,709,699
Rregullime për:			
Amortizimin		99,643,525	101,629,816
Humbje nga këmbimet valutore		-	-
Të ardhura nga investimet(Rezultati shitje AAM-ve)		7,146,140	3,609,116
Shpenzime për interesa		8,232,879	11,276,515
Rritje/rënie në tepricën e kërkesave të arkëtueshme nga al		(330,485,207)	(484,452,760)
Rritje/rënie në tepricën inventarit		25,469,397	(45,161,201)
Rritje/rënie në tepricën e detyrimeve, për t'u paguar nga aktiviteti		165,345,214	461,944,158
Mjete monetare të përfituara nga aktivitetet		**62,603,354**	**168,555,343**
Interesi i paguar		(8,232,879)	(11,276,515)
Tatim mbi fitimin i paguar		(17,800,000)	(24,866,568)
Mjete monetare neto nga aktivitetet e shfrytëzimit		**36,570,475**	**132,412,260**
Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese			
Blerja e shoqërisë së kontrolluar X minus paratë e arkëtuara		-	-
Blerja e aktiveve afatgjata materiale		(61,750,650)	(153,398,263)
Të ardhura nga shitja e pajisjeve		-	-
Interesi i arkëtuar		-	-
Dividendët e arkëtuar		-	-
Mjete monetare neto e përdorur në aktivitetet investuese		**(61,750,650)**	**(153,398,263)**
Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare			
Hyrje nga emetimi i kapitalit aksioner		-	-
Hyrje nga huamarrje afatgjata		-	38,529,640
Pagesat e detyrimeve të qirasë financiare		-	-
Dividendët e paguar		-	-
Mjete monetare neto e përdorur në aktivitetet financiare		**-**	**38,529,640**
Rritja/rënia neto e mjeteve monetare		**(25,180,175)**	**17,543,637**
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël		76,008,324	58,464,687
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël		50,828,149	76,008,324

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërese e këtyre pasqyrave financiare.

Ndërtim Imp Exp SALILLARI Shpk BERAT ALBANIA

DREJTORI
JOVAN CALO

Pasqyra e ndryshimeve në kapital
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008
(Të gjitha balancat janë në lekë)

	Kapitali i rregjistruar (aksionar)	Primi i aksionit	Rezerva ligjore statusore	Fitimi pashpërndarë	Totali
Pozicioni më 31 Dhjetor 2006	725,082,000	-	9,481,263	96,031,342	830,594,605
Efekti ndryshimeve ne politikat kontabël	-	-		-	-
Pozicioni I rregulluar	725,082,000	-	9,481,263	96,031,342	830,594,605
Fitimi neto për periudhën kontabël				94,843,131	94,843,131
Dividentët e paguar(Provizioni per rreziqe)				3,557,538	3,557,538
Rritje e rezervës së kapitalit(perov. Rreziq	-		4,801,342	(4,801,342)	-
Emetimi i kuotave(aksioneve)	91,230,000	-		(91,230,000)	-
Pozicioni më 31 Dhjetor 2007	816,312,000	-	14,282,605	98,400,669	928,995,274
					-
Fitimi neto për periudhën kontabël	-	-		77,707,978	77,707,978
Dividentët e paguar	-	-		-	-
Emetim i kapitalit aksionar	-	-			-
Rritje e rezervës së kapitalit			94,843,131	(94,843,131)	-
Aksione te thesarit te riblera	-	-	-	-	-
					-
Pozicioni më 31 Dhjetor 2008	816,312,000	-	109,125,736	81,265,516	1,006,703,252

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërese e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga drejtimi i "SALILLARI" sh.p.k dhe jane firmosur nga:

Administratoret

Pellumb SALILLARI

Isuf FERRA

Ndërtim Imp Exp SALILLARI Shpk BERAT ALBANIA

K/ FINANCËS

REPUBLIKA E SHQIPERISE QENDRA KOMBETARE E REGJISTRIMIT TE PERONAVE JURIDIKE TIRANE DEGA E REGJISTRIMIT TE PERONAVE JURIDIKE RAJONALE TAPIMORE

DREJTOR

Shënime për pasqyrat financiare
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008
(Të gjitha balancat janë në lekë).

1. Informacione te pergjitheshme

"SALILLARI " sh.p.k, eshte themeluar si nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me 10 Gusht 1994 dhe gjendet e rregjistruar ne rregjistrin tregtar(QKR), indentifikuar me NIPT-in J 62903125 G. Kapitali rregjistruar aktualisht eshte 816.312.000 leke dhe zotrohet nga ortaket Pellumb Salillari dhe Isuf Ferra. Veprimtaria kryesore tregtare e shoqerise per ushtrimin 2008 jane sherbimet ne fushen e ndertimit..

2. Permbledhje e politikave kontabel

Bazat e pergatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë pergatitur në përputhje me ligjin shqiptar "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato jane pergatitur mbi bazen e parimit te kostos historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit te te drejtave te kostatuara. Ato paraqiten ne monedhen vendase, Lekë Shqiptar ("lekë).

Standartet Kombëtare të Kontabilitetit zbatohen per here te pare dhe aplikimi i tyre, sipas kerkesave te SNK-ve, eshte bere ne menyre perspektive. Si pasoje shifrat e vitit 2008 nuk jane te krahasueshme me ato te vititt 2007, pasi jane zbatuar politika kontabel të ndryshme.
Ne paraqitjen e pasqyrave financiare te vitit 2008 eshte zbatuar formati i SKK-2 dhe per rrjedhim zerat e pasqyrave financiare te periudhes krahasuese 2007 jane riklasifikuar ne pershtatje me formatin e ri, ndryshime te cilat spjegohen ne shenimet ne vazhdim.

Parimet kontabile me domethënëse që janë pëdorur nga shoqeria, janë si më poshtë:

Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara.Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri te mjaftushme ne marrjen e perfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përllogaritet me besueshmëri.Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara. Shpenzimet njihen atehere kur ato sigurohen prej te treteve dhe ne te njejtin ushtrim kontabel me te ardhurat e lidhura.

Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci,zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e kostos historike dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.
Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqeria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2008 jane 1 euro=123.8 leke dhe 1 dollar= 87.91.

Tatimin mbi fitimin

Shpenzimi per tatimin mbi fitimin perfaqson shumen e tatimit per tu paguar per vitin ushtrimor.Tatim fitimi i pagueshem per vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem i cili ndryshon nga fitimi tregetar qe

SALILLARI Shpk BERAT ALBANIA

raportohet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin per ushtrimin 2008 eshte 10 % nga 20% qe ka qene ne ushtrimin e mëparshëm.

Kërkesat për t'u arkëtuar

Kërkesat për t'u arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në parà regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Pasivet financiare

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në parà, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara

Aktivet afatgjata materiale(AAM-të) bazohen ne modelin e kostos. Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Në se vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta nën zërin "tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi eshte llogaritur mbi bazen e metodes lineare per ndertesat dhe mbi bazen e vleren se mbetur per pjesen tjeter te aktiveve te qendrueshme. Normat e perdorura jane ne ndertesa 5 % te vleres fillestare dhe per aktivet e tjera 20% te vleres se mbetur.

Aktivet financiare afagjata

Investimet afatgjata në instrumentet e kapitalit, per mungese te një çmimi tregu të kuotuar në një treg aktiv, dhe ne pamundesi per te matur vleren e drejtë me besueshmëri , jane matur me koston e blerjes se tyre..

Gjendjet e inventaret

Vleresimi ne hyrje i inventareve behet me cmimet e blerjes dhe ne rastet kur eshte e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara per te sjelle inventaret ne kushte magazinimi. Gjendjet e inventarit ne pasqyrat financiaret paraqiten me kostot e blerjeve te fundit te ushtrimitt qe nga drejtimi eshte çmuar si vlera neto te realizueshme.

3. **Aktive monetare (likujditete në arke dhe bankë)**

Gjendjet e mjetet monetare ne banke dhe arke, ne leke dhe valute, ne datat 31 Dhjetor 2008 dhe 31 Dhjetor 2007 jane si me poshte:

Emertimi i Llogarise	Monedha	Gjendja ne 31.12.2008		Gjendja ne 31.12.2007	
		Ne leke	Ne valute	Ne leke	Ne valute
Llogari bankare	LEK	42,135,792	-	70,806,833	-
Arka ne leke	LEK	8,692,357	-	5,201,491	-
Shuma		50,828,149	x	76,008,324	x

Gjendjet e llogarive te likujditeteve te paraqitura ne pasqyrat financiare jane te njejta me te dhenat e kontabilitetit rrjedhes dhe konfirmohen me rxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike te monedhave.Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, jane përkthyer ne leke duke përdorur kursin e këmbimit të fundit te ushtrimit te bankes respektive.(shih shenimin 2)

4. Aktive të tjera financiare afatshkurtra

Kerkesat e arketueshme dhe aktive te tjera financiare, ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2008 deklarohen si vijon:

		Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2008	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2007
Aktive të tjera financiare afatshkurtra	4		
(i) Llogari / Kërkesa të arkëtueshme		1,508,935,912	1,174,464,903
(ii) Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme		15,645,476	11,374,706
(iii) Instrumente të tjera borxhi		0	0
(iv) Investime të tjera financiare		0	0
Shuma		1,524,581,388	1,185,839,609

Ne "Llogari / Kërkesa të arkëtueshme " jane pasqyruar kerkeat per tu arketuar nga klientet per shitjet e shebimeve te ndertimit dhe produkteve, te cilat nuk jane arketuar ne fund te ushterimit..Ne kete post jane vendosur dhe vlerat e akumuluara te situacioneve te ndertimit (faturave) te apartamenteve qe shoqeria nderton per shitje me fondet e veta,si dhe kerkesa te tjera te arketueshme dhe tepricat debitore te marrdhenieve me furnitoret.

Shumat e paraqitura ne "Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme" perfaqesojne tepricen debitore te "Shteti-tatim mbi fitimin" me 31.12.2008 me 9.510.476 leke dhe kerkesa te tjera per financime te perkoshme per 6.135.000 leke.

Drejtimi mendon se te gjitha kerkesat do te arketohen ne nje periudhe afatshkurter me vleren e tyre nominale dhe nuk parashikon renie ne vlere.

5. Inventari

Gjendjet e inventarit ne fillim dhe fund te ushtrimit paraqiten:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2008	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2007
Inventari		
(i) Lëndët e para	15,051,761	47,134,858
(ii) Prodhim në proces	-	-
(iii) Produkte të gatshme	7,843,600	1,229,900
(iv) Malra për rishitje	-	-
(v) Parapagesat për furnizime	-	-
Shuma	22,895,361	48,364,758

Vlerat e inventarit te paraqitura me siper perputhen me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike e kryer ne fund te ushtrimit 2008. Veprimet ekonomike qe lidhen me hyrjet e daljet

Ndërtim Imp Eksp SALILLARI Shpk BERAT ALBANIA

jane tranzituar ne llogarite e rezultatit me menyren e inventarit perhershem. Si politike kontabel ne percaktimin e kostos se inventarit eshte perdorur metoda "mesatares se ponderuar".
Vlera e inventarëve të njohura si shpenzim gjatë periudhës kontabël 2008 eshte 753.671.525 leke.
Shuma e inventarit te paraqitur ne " Lëndët e para" perfaqson stokun e materialeve qe perdoren ne procesin e ndertimit te vleresuara me koston mesatare te ponderuar.Ndersa ne " Produkte të gatshme" pasqyrohen produktet inerte gjendje ne fund te ushtrimit,te cilat do te perdoren per shitje ose konsum te brendeshem, te vleresuar me koston faktike te prodhimit.
Drejtimi mendon se vlera e paraqitur eshte vlera me e ulet mes kostos se marrjes dhe vleres neto te realizueshme dhe nuk eshte nevoja per zhvleresime te tij.

6. Aktivet Afatgjata

Aktivet Afatgjata Materiale(AAM-te)

Gjendjet dhe levizjet e aktiveve afatgjata materiale ne pasqyrat financiare paraqitet si vijon:

	Gjendjet dhe levizjet	Toka	Ndertesa	Makineri dhe pajisje	Aktivet te tjera afatgjata materiale	Totali
A	Koston e AAM-ve me 01.01.2008	201,450,002	102,238,890	818,614,452	14,567,446	1,136,870,790
	Shtesat	-	33,935,122	27,065,630	749,698	61,750,650
	Pakesimet	-	-	(9,641,500)	-	(9,641,500)
	Koston e AAM-ve 31.12.2008	201,450,002	136,174,012	836,038,782	15,317,144	1,188,979,940
B	Amortizimi AAM-ve 01.01.2008	-	23,632,367	362,836,235	7,221,269	393,691,871
	Amortizimi ushtrimit	-	5,111,945	92,812,120	1,719,460	99,643,525
	Amortizimi per daljet e AAM-ve	-	-	(2,495,360)	-	(2,495,360)
	Amortizimi i AAM-ve 31.121.2008	-	28,744,312	453,154,995	8,940,729	490,840,036
						-
C	Zhvleresimi AAM-ve 01.01.2008	-	-	-	-	-
	Shtesat	-	-	-	-	-
	Pakesimet	-	-	-	-	-
	Zhvleresimi AAM-ve 31.12.2008	-	-	-	-	-
D	Vlera neto e AAM-ve 01.01.2008	201,450,002	78,606,523	455,776,217	7,346,177	743,178,919
						-
	Vlera neto e AAM-ve 31.12.2008	201,450,002	107,429,700	382,883,787	6,376,415	698,139,904

Vlerat dhe klasifikimi ne grupe i AAM-ve te pasqyruara ne bilanc dhe ne tabelen e mesiperme jane te perputhura me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike qe shoqeria e ka kryer ne fund te muajit dhjetor 2008.
Si politike kontabel per kontabilizimin dhe spjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e kostos(SKK-5). Vleresimi fillestar ne momentin e marrjes ne inventar eshte bere me koston e marrjes dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi.
Drejtimi mendon se pergjithesisht per kete ushtrim kontabel, nuk ka shenja te renjes ne vlere te AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvleresime.
Metodat dhe normat e amortizimit te AAM-ve te perdorura jane njejta me ato qe perdoren per qellime fiskale.(shih shenimin nr.2)Masa e llogaritur e amortizimit si shpenzim nuk i tejkalon kufijte e njohur per efekte fiskale.

Aktivet Financiare Afatgjata

Gjendjet dhe levizjet e aktiveve te qendrueshme financiare ne pasqyrat financiare paraqiten:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2007	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2006
Pjesmarrje ne "Albania Consortium" sh.a	42,714,000	42,714,000
Shuma	42,714,000	42,714,000

Shoqeria eshte aksionere e "Albania Consortium" sh.a,Tirane dhe zoteron 42.714 aksione me vlere nominale 1.000 leke/aksion ose 42.714.000 leke.Gjate ushtrimit 2008 nuk ka patur transaksione te reja me aksionet dhe ndarje dividenti nga shoqeria e mesiperme.
Vleresimi e aksioneve eshte bere me koston e blerjes se tyre,per shkak te mungeses se një treg aktiv dhe pamundesise se matjes me besueshmeri me vleren e drejtë të tyre.

7. Detyrime afatshkurtera-Huamarrjet

Huate dhe parapagimet afateshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2008 paraqiten si vijon:

		Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2008	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2007
Huamarrjet	7		
(i) Huatë dhe obligacionet afatshkurtra		0	0
(ii) Kthimet / ripagesat e huave afatgjata		27,559,782	131,982,696
(iii) Bono të konvertueshme		0	0
Shuma		27,559,782	131,982,696

Ne 19 Gusht 2007 shoqeria ka marre nje hua afatgjate nga "Raiffeisen Bank" sh.a, per shumen 389.000 euro,ne nje periudhe 24 muaj, interes 7.577 % me keste mujore 16..208 euro ne muaj, principal plus interesa.Gjendja e huase me 31.12.2008 eshte 133.240 euro ose 16495.230 leke dhe nga drejtimi ajo eshte klasifikuar si afatshkurter, sepse do shlyhet brenda vitit 2008.

Gjithashtu me 01 Qershor 2008 eshte marre nje hua tjeter nga "Inteza Sanpaulo" sh.a, ne shumen 250.000 euro, me interes 7.179 %, e pagueshme me keste mujore prej 7.737 euro, principal plus interesa.Gjendja e huase me 31.12.2008 eshte 89.374 euro ose 11.064.552 leke dhe eshte klasifikuar afatshkurter pasi do shlyhet plotesisht ne vitin 2008.

8. Detyrime afatshkurtera-Huate dhe parapagimet

Huate dhe parapagimet afateshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2008 paraqiten si vijon:

		Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2008	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2007
Huatë dhe parapagimet	8		
(i) Të pagueshme ndaj furnitorëve		1,080,455,482	903,946,931
(ii) Të pagueshme ndaj punonjësve		4,714,737	0
(iii) Detyrimet tatimore+sig.shoqerore		23,164,762	2,660,885
(iv) Hua të tjera		0	0
(v) Parapagimet e arkëtuara		226,918,263	138,877,300
Shuma		1,315,253,244	1,045,485,116

"Të pagueshme ndaj furnitorëve" pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve per blerjen e mallrave e sherbimeve pa u likujduar ne fund te ushtrimit. Shoqeria ka pergatitur inventaret kontabel dhe shuma e

Ndërtim Invest Exp SALILLARI Shpk BERAT ALBANIA

llogarise sintetike eshte e barabarte me shumen e llogarive analitike te mbajtura per çdo furnitor.Drejtimi mendon se te drejtat e furnitoreve jane te vleresuara realisht.

"Të pagueshme ndaj punonjësve" perbehet nga detyrimi i papaguar ndaj personelit ne 31.12.2008.

"Detyrimet tatimore+sig.shoqerore" perfaqesojne detyrimin per tatimin mbi vleren e shtuar ne shumen 21.100.133 leke, tatimit ne burim 437.123 leke, renta minerare 90.213 leke dhe per sigurimet shoqerore e shendetesore te muajit dhjetor 2008 ne shumen 1.537.293 leke.

"Parapagimet e arkëtuara" perfaqesojne arketimet e pronotuesve te apartamenteve te banimit, ne baze te kontratave te porosise, per te cilet nuk eshte realizuar kontrata e shitjes dhe trasferimi i titullit te pronesie.

9. Detyrime Afatgjata-Huate afatgjata

Shoqeria nuk ka hua te klasifikuara si afatgjste ne fund te ushtrimit 2008.

10. Kapitalet e veta

Kapitali i rregjistruar i shoqerise, i paraqitur ne bilanc, eshte i njejte me ate te percaktuar ne statutin e shoqerise dhe vendimet e depozituara ne QKR. Me 31.12.2008 ai eshte 816.312.000 leke, i ndare ne 8.163.120 kuota me vlere nominale 1.000 leke /kuota. Me vendim te Asamblese se Ortakeve fitimi i vitit 2007 eshte destinuar perritjen e rezervave te kapitalit.Gjate ushtrimit kontabel 2008 nuk ka ritje ose pakesim ne kapitalin e rregjistruar te shoqerise dhe ne raportet zoterimit nga ortaket.

11. Fitimi (humbja) e vitit financiar

- **Te ardhurat**

Te ardhura e realizuara gjate ushtrimit, sipas segmenteve(kategorive) te biznesit paraqitet si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2008	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2007
Te ardhurat		
Te ardhurat nga shitja e produkteve	180,898,444	203,923,467
Te ardhurat nga kryerja e sherbimeve(ndertimi)	1,255,607,193	1,121,412,065
Te ardhurat nga shitja e mallrave	0	6,952,731
Te ardhurat te tjera(AAM)	46,772,764	1,434,900
Shuma	1,483,278,401	1,325,335,532

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe sherbimeve jane vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara, te zhveshura nga TVSH-ja.Të ardhurat nga sherbimet e ndertimit ne apartamente banimi, jane njohur deri në masën e shpenzimeve të rikuperueshme, të njohura në kontabilitet.(Njohja dhe vleresimi jane bazuar ne SNK-8).Paraqitja ne pasqyrat financiare e te ardhurave dhe shpenzimeve eshte bere sipas natyres se tyre.

- **Shpenzimet e veprimtarise kryesore**

Konsumi i materialeve,mallrave, furniturave, punimeve e sherbimeve, te pasqyruara ne dokumentat justifikues, jane rregjistruar me shumat e paguara ose te pagueshme.
Kostoja e punesimit, page dhe sigurime shoqerore, eshte pasqyruar saktesisht si shpenzim me vleren e realizuar dhe te dokumentuar.Taksat lokale e taksa e tatime te tjera qe lidhen me biznesin jane

Ndërtim Imp. Eksp. SALILLARI Shpk BERAT ALBANIA

llogaritur dhe pasqyruar ne llogarite e ushtrimit. Sipas natyres se tyre shpenzimet e ushtrimit 2008 jane treguar ne pasqyren perkatese.

Ne zerin "Shpenzime te tjera" pasqyruar ne piken 7 te Pasqyres se te Ardhurave dhe Shpenzimeve analizohen si vijon

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2008	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2007
Shpenzime te tjera	0	0
Furnitura,nentrajtime dhe sherbime	-	-
Energji,uje,etj	3,878,671	
Telefoni, internet	5,352,868	4,502,875
Qera	541,516	149,000
Sherbime nenkontraktore	347,175,814	292,843,041
Te tjera sherbime	402,982	5,062,336
Tatime,taksa dhe derdhje te ngjashme	11,312,076	10,120,347
Shpenzime te tjera rrjedhese	8,134,151	3,941,221
Shuma	376,798,078	316,638,820

- **Te ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Jane paraqitur si diference e te ardhurave me shpenzimet sipas kerkesave te standarteve.

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2008	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2007
Te ardhurat nga interesat 767, 667(+)	-	-
Shpenzimet per interesat 767, 668(-)	(8,232,879)	(11,276,615)
Fitimet nga kursi i kembimi 769, 669(+)	852,839	1,911,851
Humbjet nga kursi i kembimi 769, 670(-)		-
Te ardhura dhe shpenzime te tjera financiare 768, 668	-	-
Shuma	(7,380,040)	(9,364,764)

Shpenzimet per interesa jane te lidhura me kredite, te spjeguara ne shenimin nr.7

- **Shpenzime personeli**

Numri mesatar i punonjesve dhe pagat sipas kategorite kryesore jane si me poshte :

Kategorite	Ushtrimi 2008 (000 leke)			Ushtrimi 2007 (000 leke)		
	Numer mesatar	Paga	Sigurime punedhenesi	Numer mesatar	Paga	Sigurime punedhenesi
Administrator, menaxher	2	3,600	388	1	1,350	290
Specialist me arsim universitar	10	8,400	1,823	23	12,750	2,738
Teknike	15	9,000	1,953	9	2,100	451
Puntor	164	113,817	19,742	99	28,874	6,200
Shuma	191	134,617	23,906	132	45,074	9,679

SALILLARI Shpk BERAT ALBANIA

12. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimet e tatimi mbi fitimin per ushtrimin kontabel 2008 dhe 2007 jane si vijon:

		Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2008	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2007
I	FITIMI NETO PARA TATIMIT	87,251,406	119,709,699
II	SHPENZIME TE PAZBRITESHME (+)	8,182,872	4,623,141
1	Amortizime tej normave fiskale	6,835,915	3,609,116
2	Shpezime pritje e dhurime tej kufirit tatimor	-	-
3	Gjoba,penalitete,demshperblime	805,341	332,105
4	Provizione qe nuk njihen	-	-
5	Shpenzime pa dok. ose jo te regulta	541,616	149,000
6	Te tjera	-	532,920
III	PJESA E HUMBJES SE MBARTUR(-)	-	-
IV	FITIMI (HUMBJA) TATIMORE(I+II-III)	95,434,278	124,332,840
V	Shpenzimi i tatim fitimit-10%	9,543,428	24,866,568
VI	FITIMI NETO I USHTRIMIT(I-V)	77,707,978	94,843,131

Tatim fitimi i ushtrimit eshte i llogaritur mbi fitimin e tatushem, i cili eshte rregulluar nga shpenzimet e panjohura sipas legjistacionit fiscal, analizuar ne tabelen e mesiperme.

13. Transaksione te paleve te lidhura

Ne marrjen ne konsiderate te çdo transaksione dhe marredhenie te mundeshme, jo thjesht formen ligjore te tyre , ne 31 dhjetor 2008 dhe 31 Dhjetor 2007 nuk ka transaksione me palet e lidhura.

14. Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit

Asnje ngjarje e rendesishme nuk ka ndodhur pas dates se miratimit te pasqyrave financiare.
Nga analiza e gjendjes dhe performances financiare te shoqerise, rezulton se ne ushtrimin 2008 eshte rritur shifra e afarizmit por eshte ulur fitimi tregtar. Raportet e rentabilitetit per vitin 2008 jane: Fitimi mbi shitjet para shpenzimeve financiare(intresave) 6.59%, fitimi neto mbi shitjet para tatim fitimit 6.07 %.

15. Shifrat krahasuese

Shifrat krahasuese te deklaruara ne pasqyrat financiare 2007 jane riklasifikuar per tu pershtatur prezantimit te pasqyrave financiare te vitit aktual, te cilat jane ndertuar sipas SNK-ve qe aplikohen per here te para dhe ne menyre prospektive.(shih shenimin nr.2)

Ndërtim Imp Exp SALILLARI Shpk BERAT ALBANIA